



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

**Raportimi dhe Përgatitja e Pasqyrave Financiare, sipas Standardeve
Kombëtare e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

11 Korrik 2018

Seksioni 1

**Pyetje me alternativa (1 pikë secila).
Zgjidhni alternativën e saktë.**

1. Cili nga pohimet e mëposhtme NUK është i vërtetë :

- a) Sipas SKK 15 aktivet financiare paraqiten në PF me kosto ose Kosto të amortizuar kurse sipas SKK 3 paraqiten të vlerësuar me Kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes ose të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.
- b) Sipas SKK 15 inventarët në PF paraqiten të vlerësuar me vlerën më të vogël midis Kostos dhe çmimit të parashikuar të shitjes minus shpenzimet e parashikuara të përfundimit të shitjes.**
- c) Sipas SKK 15 aktivet afatgjata materiale mbahen të vlerësuar me kosto/kosto të amortizuar kurse sipas SKK 5 paraqiten në PF të vlerësuar me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë.
- d) Sipas SKK 15 kështet e pagesave që bën qiramarrësi për qiratë financiare njihen në shpenzimet e periudhës kurse sipas SKK7 kështet e pagesave të qirasë financiare nga qiramarrësi njihen si shlyerje principali dhe si shpenzime interesi.

Përgjigja e saktë alternativa B

2. Cila prej të pohimeve të mëposhtme **nuk përbën detyrim për t'u paraqitur tek shënimet shpjeguese sipas SKK-ve?**

- a) Bazat e matjes së elementëve të pasqyrave;
- b) Detaje të politikave kontabël specifike të përdorura;
- c) Numri mesatar i punësuarve gjatë vitit;**
- d) Një deklaratë për standardet kontabël të zbatuara.

Përgjigja e saktë alternativa C

3. Kur një njësi ekonomike kryen blerje ose shitje në një monedhë të huaj, është e nevojshme të përkthejë transaksionet në monedhën e saj funksionale përpara se transaksioni të përfshihet në regjistrimet financiare.

Në përputhje me SKK 12 *Efekti i kurseve të këmbimit*, cili prej rasteve të kursit të këmbimit të monedhave të huaja mund të përdoret për të përkthyer blerjet dhe shitjet në monedhë të huaj?

- 1) **Kursi i këmbimit që ishte në ditën që blerja ose shitja u krye.**
 - 2) Kursi i këmbimit që ishte në fillim të periudhës kontabël.
 - 3) **Kursi mesatar i këmbimit për vitin, duke supozuar se nuk ka pasur luhatje të konsiderueshme përgjatë vitit.**
 - 4) Kursi i këmbimit në fund të periudhës kontabël.
- a) (2) dhe (4)
 - b) Vetëm (1)
 - c) Vetëm (3)
 - d) **(1) dhe (3)**

Përgjigja e saktë alternativa D

4. Paragrafi 7 i SKK 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës” përkufizon grantet. Cili nga përkufizimet më poshtë përfshihet në këtë standard.
- a) Grantet janë ndihmë e dhënë nga një organizëm qeveritar, në formën e transferimit të burimeve apo aktiveve të një njësie ekonomike, përkundrejt plotësimit në të shkuarën ose në të ardhmen të disa kushteve të paracaktuara që lidhen me aktivitetet e shfrytëzimit të kësaj njësie ekonomike.
 - b) Grantet janë ndihmë e dhënë nga një organizëm qeveritar ose joqeveritar, në formën e transferimit të burimeve të një njësie ekonomike, përkundrejt plotësimit në të shkuarën të disa kushteve të paracaktuara që lidhen me aktivitetet e shfrytëzimit të kësaj njësie ekonomike.
 - c) **Grantet janë ndihmë e dhënë nga një organizëm qeveritar ose joqeveritar, në formën e transferimit të burimeve apo aktiveve të një njësie ekonomike, përkundrejt plotësimit në të shkuarën ose në të ardhmen të disa kushteve të paracaktuara që lidhen me aktivitetet e shfrytëzimit të kësaj njësie ekonomike**
 - d) Grantet janë ndihmë e dhënë nga një organizëm qeveritar ose joqeveritar, në formën e transferimit të burimeve të një njësie ekonomike, përkundrejt plotësimit në të ardhmen të disa kushteve të paracaktuara që lidhen me aktivitetet e shfrytëzimit të kësaj njësie ekonomike.

Përgjigja e saktë alternativa C

5. Si do të njihet investimi në pjesëmarrje në pasqyrën e konsoliduar të performancës sipas kërkesave të SKK 14 «Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrrje të përbashkëta»:
- a) Shpenzimet dhe të ardhurat e pjesëmarrjes bashkohen linjë me linjë me ato të grupit ;
 - b) Pjesa e grupit në shpenzimet dhe të ardhurat e pjesëmarrjes bashkohen linjë me linjë me ato të grupit ;
 - c) Pjesa e grupit në fitim/humbjen neto pas taksave të pjesëmarrjes njihet si një zë i vecantë në pasqyrat financiare të grupit ;**
 - d) Vetëm dividendët e fituar nga pjesëmarrja njihen në pasqyrat financiare të grupit.

Përgjigja e saktë alternativa C

6. Një ndryshim i metodës së amortizimit konsiderohet:
- a) Ndryshim në politikën kontabël;
 - b) Ndryshim në vlerësimin kontabël;**
 - c) Ndryshim në metodën kontabël;
 - d) Ndryshim në standardin kontabël;

Përgjigja e saktë alternativa B

7. XZ sh.p.k. në fund të periudhës raportuese 31.12.2017 e kishte inventarin me kosto në shumën \$10,000. Shoqëria në fund të kësaj periudhe e rivlerësoi inventarin me VNR në shumën \$9,000. Dy javë më pas më 14 janar 2018, inventari u shit me vlerën \$7,000. Në qoftë se pasqyrat financiare do të përfundoheshin më datën 14 shkurt 2018, cila do të ishte shifra e inventarit në pasqyrat financiare të periudhës që mbyllet më datën 31.12.2017?
- a) \$ 10,000;
 - b) \$ 9,000;
 - c) \$ 7,000;**
 - d) Asnjëra nga më sipër.

Përgjigja e saktë alternativa C

8. "Bartësi informatik" është çdo dokument i evidencës mbështetëse:
- a) i autorizuar nga organet përkatëse;
 - b) i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë;
 - c) Të dyja të mësipërmet;**
 - d) Asnjëra.

Përgjigja e saktë alternativa C

9. Për një njësi ekonomike është e përshtatshme të përdorë metodën e kostos së bazuar në aktivitet kur;
- a) Ka pasur ndryshime të konsiderueshme të mjedisit të biznesit, përfshi edhe adoptimin e teknologjive të reja;
 - b) Përdor një larmi teknikash prodhimi;
 - c) **Të gjitha të mësipërmet;**
 - d) Asnjëra.

Përgjigja e saktë alternativa C

10. Një njësi ekonomike e cila në ciklin e jetës së saj gjendet në fazën e maturimit në treg, zakonisht nuk karakterizohet nga:
- a) **Flukse pozitive të mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimeve të saj;**
 - b) Fluxe pozitive të mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit të saj;
 - c) Fluxe pozitive të mjeteve monetare nga arkëtimet nga klientët;
 - d) Asnjë më lart.

Përgjigja e saktë alternativa A

Seksioni II

Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar në Republikën e Shqipërisë

11. Cilat janë disa nga detyrat e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Pse mendoni që ai është i domosdoshëm **(4 pikë)**

Përgjigje:

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe në koherencë me Standardet Kontabël Ndërkombëtare. Nëse për arsye të legjislacionit dhe të praktikave kontabël brenda vendit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit e shikon të nevojshme që të shmanget nga zbatimi i disa standardeve, ai e ka autoritetin që ta bëjë një gjë të tillë, vetëm pasi të shpjegojë dhe të justifikojë arsyet e këtij veprimi;
- b) të përpunojë një sistem kontabël, ku përveç standardeve kontabël kombëtare, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, listat e llogarive dhe përdorimin e tyre, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;

d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;

dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin.

(vleresohet me 3 pike, mjafton të permende tre detyra kryesore të sipercituar)

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit bazuar në aktet ligjore e nënligjore është krijuar si një organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik, dhe duke patur të gjitha drejtat e sipërmendura, krijimi i Tij është mjaft i domosdoshëm dhe i rendesishëm sepse nepermjet tij mundësohet jo vetëm vendosja e një seti të plotë standardesh por njëkohësisht edhe koherenca e vazhdueshme me SNRF/SNK, duke siguruar “një gjuhë të njëjtte të biznesit”, transparente dhe të krahasueshme dhe me vendet e tjera të BE-se.

(vleresohet me 1 pike)

Seksioni III

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

12. Dalmar sh.p.k. është një shoqëri që po harton PF të datës 31 dhjetor 2017 sipas SKK. Ajo ka nevojë për të sqaruar dhe trajtuar saktë në kontabilitet disa situata të saj dhe ju drejtohet ju si KM. Situatat janë si vijon:

(5 pikë)

- a) zotëron në vitin 2017 një kamion me vlerë kontabël 2,000,000 lekë dhe amortizim të akumuluar 500,000 lekë. Kamioni është i prodhimit të vitit 2005. Dalmar sh.p.k. e ka përdorur në të kaluarën për transport të produkteve të cilat ajo i shet për klientët e saj. Në 1 janar 2018 hyn në fuqi një Ligj i ri për mjetet e transportit i cili nuk e lejon më përdorimin e këtij kamioni për shkak të ndotjes që shkakton. Ai nuk mund të modifikohet për t’u përshtatur kërkesave të këtij ligji. Po ashtu Dalmar nuk ka gjetur, pavarësisht përpjekjeve të bëra, blerës për tja shitur dhe kamioni nuk ka asnjë vlerë për skrap.
- b) Dalmar shet produkte për të cilat nuk jep një garanci kontraktuale. Por menaxheri i ri që ka ardhur para dy viteve ka zbatuar një politikë tregtare për pranimin e mallrave që ju ka shitur klientëve të saj brenda 30 ditëve nga data e blerjes. Kjo politikë është zbatuar këto dy vite megjithëse nuk është kontraktuale. Mjafton të paraqesin kuponin dhe malli të mos jetë i dëmtuar. Dalmar këto mallra ose ja u zëvendëson ose i kthen mjetet monetare. Kjo ka bërë që për dy vitet e fundit shitjet të rriten me 25% dhe fitimi të rritet me 30%.

Kërkohet:

Tregoni trajtimin kontabël që do të këshillonit ju tek secili prej këtyre rasteve duke dhënë në mënyrë të përmbledhur dhe argumentimin përkatës. Tregoni dhe regjistrimet që duhet të kryejë shoqëria në 31.12.2017.

Përgjigje:

- (a) Duke qenë se Dalmar nuk lejohet me ligj të përdorë kamionin, ky i fundit nuk mund të kontribuojë në fluksin e mjeteve monetare të shoqërisë, duke u përdorur në procesin e transportit të produkteve të njësive ekonomike. Po ashtu ai nuk gjeneron MM edhe sepse nuk ka blerës që ta blejnë. Më tej, duke qenë se kamioni nuk ka asnjë vlerë për skrap, njësia ekonomike nuk mund të gjenerojë MM nëpërmjet shitjes së tij. Në këtë rast nuk është e mundshme që kamioni të gjenerojë përfitime të ardhshme ekonomike për njësinë ekonomike dhe kështu që nuk mund të njihet më si një aktiv. Dalmar duhet ta njohe si shpenzim (humbje) nga vlera e mbetur e kamionit. **(1.5 pikë)**

Regjistrimi kontabel (1 pikë)

Debi Amortizim i Akumuluar Kamioni	500,000
Debi Humbje (VKN) nga dalja e Kamionit	1,500,000
Kredi Kamioni	2,000,000

- (b) Në këtë rast qëllimi për të kthyer mbrapsht tek klienti paratë apo mallin do të trajtohet si një detyrim (konstruktiv) edhe pse konsumatori nuk ka asnjë të drejtë ligjore për të detyruar shitësin për kthimin e parave. Kjo sepse nëse nuk do të kthehen mallrat apo paratë do të ndikonte kjo në uljen e të ardhurave nga shitja dhe fitimet dhe si rrjedhim alternativa më e mirë realiste nga pikepamja ekonomike është të pranohet dhe të njihet detyrimi dhe shpenzimi. Dalmar duhet të bëjë bazuar në eksperiencën e kaluar vlerësimin e kthimeve të mundshme bazuar në përqindjen e kthimit dhe në koston mesatare të një kthimi **(1.5 pikë)**

Regjistrimi që duhet të bëhet në këtë rast do të ishte: **(1 pikë)**

Debi	Shpenzime
Kredi	Detyrime konstruktive për shitje me të drejtë kthimi

- 13.** Shoqëria X sh.a. është duke ndërtuar PF më 31.12.2017. Ajo zbaton SKK. Në datën 31 dhjetor 2017 ajo ka një gjendje të një malli A të vlerësuar me kosto prej 2 milion lekë. Po ashtu ka një gjendje të investimeve në aksionet e një shoqërie A prej 20 mil lekë. Shoqëria sipas kërkesave të SKK përdor vlerësimin e inventarëve me vlerën më të vogël midis koston (FiFo) dhe çmimit të parashikuar të shitjes minus shpenzimet e parashikuara të përfundimit të shitjes, dhe për investimin në aksione, zbaton vlerësimin me vlerën e drejtë.

Në 22 janar 2018, kur ende PF nuk janë publikuar, ajo merr informacionin që vlera e tregut e aksioneve të shoqërisë A për pjesën që zotëron X shpk është 29 mil lekë dhe vlerësohet që të jetë e tillë . Po ashtu ajo në 3 shkurt e ka shitur sasinë e mallit A me një çmim prej 1.5 milion lekë. Shpenzimet e shitjes që ka paguar shoqëria ishin 250 mijë lekë.

Kërkohet: Tregoni trajtimin kontabël që bën shoqëria bazuar në këtë informacion dhe paraqisni regjistrimet kontabël kur janë të nevojshme: **(5 pikë)**

Përgjigje:

- a) Në rastin e Investimit kemi të bëjmë me një ngjarje pas datës së përfundimit të PF. Por ajo nuk tregon kushtet që kanë ekzistuar në 31.12.2017. Kjo sepse IAGJ vlerësohen me vlerën e drejtë në datën e ndërtimit të PF. Prandaj shoqëria nuk duhet të bëjë korrigjimin e vleftës së investimeve në PF të vitit 2017. Por ajo duhet të japë sqarimin përkatës në shënimet e PF, 1.5 pikë Sqarimi në shënimet shpjeguese është : Shoqëria ka vlerësuar IAGJ me Vlerën e Drejtë në 31.12.2017 prej 20 milion lekë. Por çmimi i aksioneve dhe i IAGJ në vitin 2018 është rritur dhe vlera e IAGJ është 29 mil lekë 1 pikë
- b) Për mallrat: Shoqëria duhet të trajtojë shitjen e mallrave A në shkurt 2018 si një ngjarje pas datës së përfundimit të periudhës raportuese. Kjo është një ngjarje që tregon kushtet që kanë ekzistuar në datën e ndërtimit të PF sepse vlefata e inventarit në 31.12.2017 vlerësohet me çmimin e parashikuar të shitjes. Dhe ky çmim i parashikuar i shitjes në 3 shkurt 2018 merret informacioni që ka ndryshuar. Prandaj ajo duhet të bëjë dhe ndryshimin e vleftës së inventarit gjendje të mallit në 31.12.2017. Pra ajo duhet të bëjë përsëri krahasimin midis Kostos dhe çmimit të parashikuar të shitjes minus shpenzimet e parashikuara të shitjes. Llogaritjet:

Kosto = 2 mil

Çmimi i parashikuar i shitjes - shpenzimet e shitjes = $1.5 - 0.25 = 1.25$ milion. Me këtë vlerë do paraqitet inventari më 31.12.2017 2 pikë

Regjistrimi në ditar për PF të 2017 do të jetë: 0.5 pikë

Debi Humbje nga rivlerësimi i inventarit 0.75 mil

Kredi Mallra

0.75 mil

14. Argumento përgjigjen për njohjen e kontributeve

(6 pikë)

(a) Me qëllim mbledhjen e fondeve, Departamenti i muzikës në Kolegjin e Arteve organizoi një koncert ku orkestrën e drejtoi një emër shumë i njohur i muzikës. Biletat e aktivitetit u shitën për një çmim 2.000 lekë dhe përfshihej në çmim një pritje cocktail përpara shfaqjes (vlera e drejtë 250 lekë), pranimit në koncert (vlera e drejtë 300 lekë) si dhe një pritje me orkestrantët pas shfaqjes (vlera e drejtë 150 lekë).

Janë biletat e kësaj shfaqjeje të veçantë artistike një kontribut?

Përgjigje:

Teprica mes çmimit të biletës (2.000 lekë) dhe vlerës së drejtë të shpenzimeve të përballuara (700 lekë) përfaqëson masën e kontributit (1.300 lekë).

(b) Një Fondacion shumë i njohur, i cili ka në programin e tij të mbështesë shfaqet muzikore, i jep fonde Departamentit të muzikës në Kolegjin e Arteve. Donatori (Fondacioni) specifikon se fondet do të përdoren për të mbështetur shfaqet dhe performancat e artistëve. Si pjesë e programit të tij të zakonshëm, departamenti i muzikës i përdor këto fonde për të kompensuar artistë individual që performojnë në kolegji dhe japin mësim në klasa të ndryshme të nivelit master.

Është ky një kontribut ?

Përgjigje:

Po. Kolegji i arteve nuk vepron si një ndërmjetës për këta artistë. Fondet mbështesin një program të vazhdueshëm të departamentit të muzikës dhe duhet të njihen si kontribut

(c) Kolegji i Inxhinierisë Mjedisore merr një shumë 100.000 usd nga një korporatë naftë për të bërë një kërkim shkencor mbi efektet e disa aditivëve të rinj të benzinës në nivelin e ndotjes së ajrit dhe kushtet e motorëve të automjeteve. Kolegji ra dakord të ndjekë propokollin e kërkuar nga korporata për sa i takon detyrimeve për afatet dhe raportet që duhen dorëzuar në fund të periudhës së kërimit. Kolegji ka vlerësuar se kostot direkte për realizimin e këtij kërkimi shkencor do të shkojnë deri në 75.000 usd. Kolegji bie dakord që të mos i publikojë gjetjet e kërimit shkencor për të paktën 2 vjet pas përfundimit të tij. Pas kësaj periudhe, kërkimi shkencor mund të publikohet, por duhet të shoqërohet me falenderimin për mbështetjen financiare të dhënë nga Korporata.

Është ky transaksion një kontribut?

Përgjigje:

Jo. Shuma e paguar është për një transaksion shkëmbimi. Kërkimi shkencor është drejtpërdrejt i lidhur me interesat e korporatës dhe biznesin e saj. Nëse do të ketë sukses, aditivi do të sjellë fitime të shumta për korporatën. Korporata ka vendosur kushte ekskluzive mbi kërkimin shkencor, rasti i mospublikimit për një periudhë të caktuar të gjetjeve të kërkimi shkencor, fakt ky që i jep mundësi dhe avantazhe konkurruese korporatës. Diferenca mes kostos së vlerësuar dhe shumës së arkëtuar është një vlerësim i arsyeshëm i kostove indirekte të lidhura me projektin e kërimit shkencor.

(d) Një familje e pasur i jep Universitetit "A" një shumë 1.000.000 euro por i kërkon ta investojë atë për 10 vjet dhe fitimin që sigurohet nga investimi ta përdorë në mbështetje të programit për arsimimin e femrave. Në fund të periudhës 10 vjeçare, Universiteti mund ta përdorë shumën (principalin dhe interesat) për çfarë t'i nevojitet.

Si duhet njihet ky transaksion?

Përgjigje:

Ky është një fond me kufizim në kohë të përdorimit të tij. Duhet njohur si aktiv neto i kufizuar. Në fund të periudhës 10 vjeçare riklasifikohet tek aktivet neto të pakufizuara.

15. Njësia ekonomike A ka selinë e saj qendrore në qendër të qytetit. Ajo zotëron një ndërtesë në periferi që i'a ka dhënë me qira një njësie ekonomike tjetër B. Një tërmet më 30 qershor 2017 e shkatërroi plotësisht këtë ndërtesë. Meqë njësia A e ka njësinë B një klient të rëndësishëm, ka vendosur që t'i japë 60% të ndërtesës të selisë qendrore me qira si "kompensim".

(6 pikë)

Informacion më i hollësishëm për ndërtesën e selisë qendrore është dhënë më poshtë:

- Është blerë më 1 janar 2017 për 600 000 €
- Jeta e dobishme gjithsej 10 vjet (vlera e mbetur=0)
- Vlerat e drejta: 800 000 €uro më 30 qershor 2017 dhe 820 000 €uro më 31 dhjetor 2017.
- Është e mundur të shitet ose të jepet me qira pjesa prej 60% e ndërtesës veças nga pjesa tjetër e ndërtesës.

Firma A përdor:

- Modelin e vlerës së drejtë për të matur aktivet afatgjata të investuara dhe
- Modelin e kostos për të matur aktivet afatgjata materiale.

Kërkohet:

1. Cili do të ishte trajtimi kontabël i ndërtesës bazuar në SKK 5? Shpjegoni.
2. Paraqitni artikujt kontabël në lidhje me ndërtesën për periudhën 2017.

Shpjegoni a ndryshon trajtimi kontabël i një aktivi afatgjatë material i investuar sipas modelit të vlerës së drejtë nga trajtimi kontabël i një pasurie të zotëruar nga pronari sipas modelit të rivlerësimit.

Përgjigje:

(a) Në **1 janar 2017** ndërtesa e selisë qendrore njihet si AAM me koston e blerjes 600.000 euro; Në **30 qershor 2017** ndërtesa konsiderohet pasuri e përzier, 40% e saj është AAM dhe 60% e saj është AAMI sepse pjesa e dhënë me qira mund të jepet ose mund të shitet veçmas; Në **31 dhjetor 2017**, pjesa e ndërtesës që mbahet për shfrytëzim nga njësia ekonomike paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me koston munis amortizimin e akumuluar ndërsa pjesa e ndërtesës që është dhënë me qira paraqitet me vlerën e drejtë të saj.

(b) Veprimet kontabël:

1 janar 2017

D Ndërtesa (AAM)	600.000
K Mjete monetare	600.000

Blerja e ndërtesës (AAM)

30 qershor 2017

D Ndërtesa (AAMI)	138.000	$(800.000 - 570.000^1) * 60\%$
K Fitim nga rritja e vlerës së drejtë	138.000	

¹ Shpenzimi i amortizimit deri në 30 qershor është 30.000 eur $(600.000 / 10 / 2)$

- *Vlera kontabël e ndërtesës (AAM) në 30 qershor është 570.000 eur (minus amortizimin 6 mj të akumuluar). Pasuria e përzier, pas riklasifikimit në po këtë datë përbëhet nga $570.000 * 40\% = 228.000$ eur AAM dhe $570.000 * 60\% = 342.000$ eur AAMI. Meqenëse në 30 qershor, kur bëhet riklasifikimi i pasurisë, disponohet vlera e drejtë, atëherë për atë pjesë të pasurisë së përzier që i takon AAMI-së bëjmë rivlerësimin me vlerën e drjtë. Vlera e ndërtesës (AAMI) bëhet 480.000 eur = $342.000 + 138.000$ ($570.000 * 60\%$)*

31 dhjetor 2017

D Shpenzime amortizimi 54.000 (30.000 6mj I + 228.000 / 9.5 6 mj II)
K Amortizimi i akumuluar 54.000

Njohja e shpenzimit të amortizimit vjetor për AAM-në

D Ndërtesa (AAMI) 12.000
K Fitim nga rritja e vlerës së drejtë 12.000
($820.000 * 60\% = 492.000$; $492.000 - 480.000 = 12.000$)

Njohja e fitimit nga rritja e vlerës së drejtë të AAMI

(c) Aktiv afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të paraqitet me vlerën e drejtë në çdo datë të raportimit me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim/humbje.

Në dallim nga AAMI, kur për AAM-të (pasuri e zotëruar nga pronari) përdoret modeli i rivlerësimit, ka këtë specifikë:

- Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Por shuma e rivlerësimit njihet si e ardhur në pasqyrën e të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që ajo anulon humbjen nga rivlerësimi i të njëjtit aktiv në periudhat kontabël paraardhëse.
- Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Por shuma e humbjes nga rivlerësimi debitohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin “tepricë nga rivlerësimi”, për sa kohë dhe në atë masë që ajo kompenson një gjendje kreditore që mund të ekzistojë nga rivlerësime të mëparshme të këtij aktivi.

16. Shoqëria ABC po planifikon të ndryshojë procesin e prodhimit dhe drejtorët kanë kuptuar që vetëm me përdorimin e një teknologjie më të avancuar led është mënyra e vetme në të cilën kompania duhet të fokusohet për të qëndruar konkurruese në treg. Shoqëria ABC kryen operacionet e saj të biznesit në një ndërtesë të marrë me qira dhe marrëveshja e qirasë u krijua me qëllim që kompania të maksimizojë përfitimin nga taksimi. Megjithatë, në pasqyrat financiare të Shoqërisë ABC nuk ka të regjistruar qira në aktive ose detyrime në datën aktuale.

Një financieri ri u punësua në Shoqërinë ABC pas mbylljes së vitit në datë 30 Prill 20X8. Ai rishikoi pasqyrat financiare për t'i përgatitur për qëllime auditimi që pritet të zhvillohet duke qenë se Shoqëria ABC ka aplikuar për një hua financiare në mënyrë që të financojë teknologjinë e re. Financieri mendon se qiraja e lidhur me tokën dhe ndërtesën duhet të trajtohet si një qira financiare, por drejtori i financës nuk është dakord. Drejtori i financës nuk dëshiron të rregjistrojë qiranë në pasqyrën e pozicionit financiar, por dëshiron të vazhdojë ta trajtojë atë si një si qira operationale. Drejtori mendon se kjo hua nuk i përmbush kriteret si qira financiare. Është bërë e qartë nga Drejtori i financës se nëse paraqitet si qira financiare Shoqëria ABC mund të rrezikojë marrjen e huasë.

Trajtoni problematikat profesionale me të cilat përballet në rastin e mësipërm kontrolluesi financiar.

(5 pikë)

Përgjigje:

SKK 7 diferencon qiranë operationale dhe qiranë financiare. Një qira financiare është një qira e cila **transferon të gjithë risqet dhe përfitimet e pronarit tek qiramarrësi**. Gjithë qiratë e tjera klasifikohen si qira operationale. Klasifikimi, që realizohet në fillim të qirasë varet më shumë nga **përmbajtja** sesa forma. Klasifikimi shpesh **kërkon gjykim dhe mund të jetë subjektiv**, specifikisht në rastet e **qirasë së tokës**. Në përgjithësi, toka ka një jetë të dobishme pa afat, prandaj pagesat e qirasë për të klasifikohen si qira e zakonshme, përveç rastit kur titulli i pronësisë i kalon qiramarrësit

Trajtimi i duhur që duhet zgjedhur duhet të marrë në konsideratë **përmbajtjen e transaksionit** si dhe të **gjitha faktet e rastit**.

Zgjidhja duhet të nxitet nga **standardet teknike dhe profesionale, jo nga dëshira për të paraqitur një pamje të favorshme për një qëllim të caktuar**. Kështu nëse kushtet e qirasë plotësojnë kërkesat e SNK 7 *Qiratë* për qira financiare, qiraja nuk duhet të trajtohet si një qira operationale me qëllim të zvogëlimit të detyrimeve të njesisë ekonomike me qëllim të ngritjes së një kredie. Nëse drejtori i financës po përpiqet ta detyrojë kontrollorin financiar për të ndryshuar atë që do të ishte trajtimi i duhur, atëherë kjo e përballë financierin me një dilemë etike.

17. Shoqëria ABC ka kryer shpenzimet e mëposhtme në importimin e materialeve në mënyrë që të prodhojë pjesët e kamionëve:

(6 pike)

	\$
Cmimi i blerjes së lëndës së parë	\$55,000
Zbritje për blerjet	2,000
Detyrimet e importit dhe taksat e tjera të pakthyeshme të blerjes	1,000
Mallra dhe sigurime për blerjet	3,000
Taksat e rimbursueshme të blerjes	2,000
Kosto të tjera të trajtimit të lidhura drejtpërdrejt me importet	4,000
Kostot e garancisë pas shitjes	5,000
Kosto e blerjes	
Pagat e punonjësve të fabrikës	10,000

Paga e mbikëqyrësit të fabrikës	5,000
Shërbime komunale të fabrikës	1,000
Pagat e departamentit të kontabilitetit	6,000
Zhvlerësimi i ndërtesës dhe pajisjeve të fabrikës	2,000
Zhvlerësimi i mjeteve të përdorura nga stafi i shitjeve	3,000
Komisionet e shitjeve të pagueshme për agentët e shitjes	4,000

Përlllogaritni vlerën me të cilën duhet të njihet inventari i pjesëve të prodhuara të kamionit në pasqyrat financiare si dhe paraqit rregjistrimet kontabël të nevojshme për njohjen fillestare të tij.

Përgjigje:

	\$	Llogaritja e kostos së inventarit	Komente
Çmimi i blerjes për pjesët e kamionëve	55,000	55,000	
Zbritje për blerjet	2,000	(2,000)	Zbriten nga çmimi i blerjes
Detyrimet e importit dhe taksat e tjera të pakthyeshme të blerjes	1,000	1,000	
Mallra dhe sigurime për blerjet	3,000	3,000	
Taksat e rimbursueshme të blerjes	2,000*	0	Nuk përfshihen në koston e mallit
Kosto të tjera të trajtimit të lidhura drejtpërdrejt me importet	4,000	4,000	
Kostot e garancisë pas shitjes	5,000*		Nuk përfshihen në koston e mallit
Kosto e blerjes		\$61,000	\$61,000
Pagat e punonjësve të fabrikës	10,000	10,000	
Paga e mbikëqyrësit të fabrikës	5,000	5,000	
Shërbime komunale të fabrikës	1,000	1,000	
Pagat e departamentit të kontabilitetit	6,000**		
Zhvlerësimi i ndërtesës dhe pajisjeve të fabrikës	2,000	2,000	
Zhvlerësimi i mjeteve të përdorura nga stafi i shitjeve	3,000**		
Komisionet e shitjeve të pagueshme për agentët e shitjes	4,000**		
		\$18,000	\$18,000
Kostoja e inventarit			\$79,000

* nuk përfshihen në koston e mallit

**Nuk janë kosto të lidhura drejtpërdrejtë me prodhimin ndaj nuk përfshihen në koston e pjesëve të kamionit

Veprimi kontabël	\$	\$
D Inventari	79,000	
K Mjete Monetare		77,000
K. Amortizim i akumuluar - ndërtesa,pajisje fabrikës		2,000

Sa më poshtë nuk është e rëndësishme që të jete si zgjidhje e dhënë nga ana e studentit. Eshtë vetëm për qëllim shpjegimi se cilat kosto përfshihen në koston e inventarit

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Shembuj të shpenzimeve që nuk mund të përfshihen në koston e inventarit janë dhënë më poshtë:

- (a) shpenzimet e punëve kërkimore
- (b) shumat mbi normalen nga dëmtimet, firot, kostot e prodhimit dhe të punës, penalitete dhe të tjera të ngjashme;
- (c) shpenzimet e shitjes
- (d) shpenzimet e përgjithshme të administrimit që nuk kontribuojnë në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale.

Shembuj të shpenzimeve që mund të përfshihen në koston e inventarit janë dhënë më poshtë:

a) Kosto të drejtpërdrejta

- a. materialet e prodhimit;
- b. pagat e punëtorëve të prodhimit;
- c. shpenzimet e punësimit të punëtorëve të prodhimit (p.sh. pagesat e pensioneve dhe të sigurimeve shoqërore);
- d. humbjet teknike të materialeve (firot).

b) Kosto jo të drejtpërdrejta

- a. pagat e personelit mbikqyrës në prodhim dhe shpenzimet e punësimit të tyre (sigurimet shoqërore);
- b. pagat e ndonjë personeli tjetër që nuk ka të bëjë në mënyrë direkte me prodhimin;
- c. materiale që nuk përdoren në mënyrë direkte në prodhim;
- d. qiraja, mirëmbajtja, sistemi i ngrohjes dhe i ndriçimit, disa taksa (duke përjashtuar tatimin mbi të ardhurat) dhe shpenzime të tjera indirekte që kanë të bëjnë me drejtimin e fabrikës;
- e. kostot inxhinierike të projekteve zhvillimore.

18. Shoqëria X, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, që përgatit pasqyra financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2017. Drejtoria e finances ka nevojë për këshillim për dy çështje. **(6 pikë)**

- a) Shoqëria X ka zhvilluar një database gjatë vitit financiar që mbyllet më 31 dhjetor, dhe e ka përfshirë në Aktivet Afatgjata Jomateriale me kosto prej Lek 3 milion. Kosto e aktivit përshin kostot e jashtme dhe të brendëshme për zhvillimin e tij. Një aktiv

afatgjatë i tillë, amortizohet përgjatë 5 viteve, dhe shpenzimi i amortizimit të një viti është ngarkuar në pasqyrat financiare. Database do të përdoret për të prodhuar një manual teknik kontabiliteti, që përdoret nga kompania dhe shitet edhe tek palët e treta. E ardhura nga shitja e manualit gjatë 4 viteve të ardhshme të jetës së tij vlerësohet të jetë 2 milionë lekë. Në fund të vitit të katërt manuali kërkon rishikim total. Kostot për mirëmbajtjen e databases dhe manualit rregjistrohen si shpenzime kur ndodhin. Shoqëria X kërkon të rregjistrojë një provizion për koston e rishikimit të manualit.

Argumentoni nëse çështja e mësipërme duhet trajtuar në pasqyrat financiare të shoqërisë në kuadër të SKK 6 Provizionet, detyrimet dhe aktivet e pakushtëzuara.

Përgjigje:

Njohja e një aktivi afatgjatë jo material ndodh nëse aktivi blihet. Gjithashtu edhe shpenzimet e zhvillimit njihen në koston e aktivit nëse vlera kontable e tij është e rikuperueshme. Në shembullin e mësipërm, kostot e jashtme kanë të bëjnë me kostot e blerjes, dhe kostot e brendshme me koston e zhvillimit. Kapitalizimi dhe amortizimi i aktivit duket i arsyeshëm. Megjithatë do të keshilloja Shoqërinë X të ndryshonte jetën e dobishme të aktivitetit në 4 vjet, meqenëse paraqet një vlerësim më realist të përdorimit të tij.

Për sa i përket provizionit, që një provizion i tillë duhet të plotësohen 3 kushte: 1) në datën e mbylljes së pasqyrave duhet të ketë një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv; 2) duhet të jetë i mundur një vlerësim relativisht i saktë i shumës së një provizioni të nevojshëm; 3) njohja ndodh vetëm nëse mundësia për realizimin e tij është më e madhe se mosrealizimi i tij. Në rastin konkret, nuk ka një detyrim as ligjor as konstruktiv për rishikim të manualit në fund të periudhës raportuese. Për këtë arsye nuk njihet asnjë provizion me datë 31 dhjetor 2017. (2 pike)

- b) Në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, bilanci verifikues tregon një gjendje kreditore prej 1,500 lekë për detyrimin e tatimit të shtyrë në fillim të vitit financiar.
- Gjatë vitit, diferencat e përkohshme të taksueshme u rritën me 4,000 lekë.
 - Në datën e raportimit, kompania ka zhvlerësuar inventar me vlerë 100,000 lekë pasi ka përllogaritur që çmimi i vlerësuar i shitjes pakësuar me kostot për t'u shitur është 90,000 lekë. Zhvlerësimi nuk njihet për efekte tatimore.

Përllogaritni detyrimin/ aktivin e tatimit të shtyrë në fund të periudhës në secilin nga situatat e mësipërme. Norma e tatimit mbi fitimin për periudhën raportuese është 30%. Komisionet parlamentare kanë diskutuar dhe miratuar në parim propozimin e Këshillit të Ministrave për ulje të normës së tatimit në 20%. Ligji pritet të miratohet pas nënshkrimit të pasqyrave financiare.

Përgjigje:

(4 pike)

Sipas SKK matja një detyrim (aktiv) tatimor të shtyrë bëhet duke përdorur normat tatimore që ajo pret të jenë të zbatueshme ndaj fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore) të periudhave në të cilat ajo pret që aktivi tatimor i shtyrë të realizohet ose detyrimi tatimor i

shtyrë të shlyhet. Ne rastin konkret, kemi tregues që norma e re e tatimit është miratuar në thelb dhe pritjet të miratohet të shpejti.

Detyrimi i tatimit të shtyre në fillim të viti Lek 1,500 (vlerësuar me 30%), diferencat e perkoheshme në fillim të vitit kanë qenë Lek 1,500 / 0.3 = Lek 5,000

Gjatë vitit diferencat e perkoheshme u rriten me Lek 4,000, si rrjedhim detyrimi i tatimit të shtyre është rritur. Totali i diferencave të perkoheshme në fund të vitit do të jetë Lek 9,000. Ndërsa **detyrimi i tatimit të shtyre** llogaritet duke aplikuar normën e re të pritshme të tatimit prej 20%, pra Lek 9,000 x 20% = Lek 1,800.

Zhvlerësimi i inventarit nuk njihet për efekte tatimore në momentin e zhvlerësimit, por efekti lehtësues tatimor do të ndihet në momentin kur ai do të shitet. Si rrjedhim, do të kemi një diferencë ndërmjet vlerës së tij kontabel të matur me çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u shitur prej Lek 90,000 me bazën tatimore të inventarit që është e barabartë me koston e tij Lek 100,000. Kjo diferencë e perkoheshme është **e zbritshme** (Lek 10,000), dhe në këtë rast një **aktiv tatimor i shtyre** do të njihet prej Lek 2,000 = Lek 10,000 x 20%.

Nëse mbledhim efektin e dy kërkesave, në fund të vitit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar do të kemi një aktiv tatimor të shtyre prej Lek 200 si rezultat i netimit të një detyrimi tatimor të shtyre prej Lek 1,800 me një aktiv tatimor të shtyre prej 2,000. Netimi i tyre lejohet sipas SKK.

		detyrimi (aktiv) i tatimit të shtyre	diferenca e perkoheshme
Në fillim të vitit	30%	1500	5000
Ndryshimi gjatë vitit:			
<i>kërkesa (i)</i>	20%	800	4000
<i>kërkesa (ii)</i>	20%	-2000	-10000
(*) ndryshimit në detyrim si efekt i ndryshimit të normës së tatimit mbi diferencat e krijuara në të kaluarën.		-500	
Në fund të vitit	20%	-200	-1000

19. Shpjegoni rastet kur krijohen diferencat e perkoheshme sipas SKK 11 Tatimi mbi fitimin.

(5 pikë)

Përgjigje:

Diferencat e perkoheshme krijojnë kur:

- (a) në njohjen e aktiveve ose detyrimeve, ka një diferencë mes vlerave kontabël dhe bazave tatimore të tyre, ose kur krijohet një bazë tatimore (për ato zëra që kanë një bazë tatimore) por nuk njihet asnjë aktiv apo detyrim;

Shembull: Vlera kontable e interesit të arketueshme është 100. E ardhura nga interesi tatohet në baza kesh. Baza tatimore e interesit të arketueshme është zero.

- (b) pas njohjes, lind një diferencë mes vlerës kontabël dhe bazës tatimore, për shkak se e ardhura ose shpenzimi njihet në kapital në një periudhë raportuese të caktuar, ndërkohë që në fitimin e tatueshëm njihet në një periudhë raportuese tjetër;

Shembull: Zhvlerësimi i inventarit nuk njihet për efekte tatimore në momentin e zhvlerësimit, por efekti lehtësues tatimor do të ndihet momentin kur ai do të shitet.

Shembull: Ka ndryshime ndërmjet metodës së amortizimit që përdoret për të përcaktuar fitimin e tatueshëm dhe fitimit kontabel

- (c) baza tatimore e një aktivi ose detyrimi ndryshon dhe ndryshimi nuk ndikon në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit, në asnjë periudhë raportuese.

Diferencat e përkohshme krijohen gjithashtu edhe kur:

- (d) kostoja e një kombinimi biznesesh shpërndahet mbi bazën e vlerës së drejtë të aktiveve të identifikueshme të blera/përfutuara dhe të detyrimeve të marra, ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon;

- (e) aktivet rivlerësohen ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon.

Shembull: Kur aktivet afatgjata materiale maten me metodën e rivlerësimit.

20. Njohja e të ardhurave nga kryerja e shërbimeve dhe nga kontratat e ndërtimit bazohet në metodën e fazës së përfundimit të transaksionit. Cilat janë metodat që mund të përdoren për të përcaktuar fazën e përfundimit – shtjelloni shkurtimisht secilën metodë duke dhënë nga një shembull ilustrues për secilën. Pse pagesat progresive për punimet/shërbimet, apo parapagimet e bëra nga blerësi nuk përputhen gjithnjë me punën e kryer? **(5 pikë)**

Përgjigje:

Njesia ekonomike përcakton fazën e përfundimit të një transaksioni ose kontratë ndërtimi duke përdorur metodën që mat në mënyrën më të besueshme punën e kryer.

Metodat e mundshme që mund të përdoren janë:

- a) Metoda që bazohet në pjesën që zëne në kostot totale të vlerësuar për përfundimin e një kontrate ndërtimi, shpenzimet e bëra për punën e kryer deri në datën e raportimit. Kostot aktuale nuk përfshijnë kostot që lidhen me aktivitetet e ardhshme si parapagimet, apo shpenzimet për materiale që nuk janë konsumuar deri në datën e raportimit.

Ilustrim: Ne tenderat per kontrata ndertimi, shoqeria tenderuese/fituese paraqet nje preventive qe perkon me kostot totale te vleresuara per perfundimin e nje kontrate ndertimi. Situacionet mujore te punimeve faktike, mund te perdoren per te llogaritur fazen e perfundimit te kontrates duke krahasuar kostot aktuale me ato totale te vleresuara deri ne perfundim.

- b) Metoda qe bazohet ne inspektimin e punes se kryer. Sipas kesaj metode, faza e perfundimit te nje kontrate percaktohet ne terren, bazuar ne inspektimet e punes se kryer dhe realizohet nga inxhinieret dhe supervizoret e punimeve. Gjykimi i tyre eshte vleresimi me i mire i fazes se perfundimit te kontrates ne daten e raportimit.

Ilustrim: Supervizori i punimeve ne nje kontrate ndertimi, percakton, bazuar ne vizitat ne terren, perqindjen e punimeve te perfunduara deri ne daten e mbylljes se pasqyrave.

- c) Metoda qe bazohet ne perfundimin fizik te nje pjese te punimeve te ndertimit. Kjo eshte metode e ngjashme me metoden b), por ne kete rast punimet e perfunduara jane te identifikueshme fizikisht.

Ilustrim: Nje kontrate ndertimi per ndertimin e nje kompleksi turistik mund te perfshije ndertimin e nje hoteli, si edhe te disa vilave per pushim. Ne kete rast, perfundimi i punimeve per hotelin mund te identifikohet fizikisht nga punimet per vilat.

Te ardhurat nga kontratat e ndertimit, do te njihen ne pasqyrat financiare duke aplikuar fazen e perfundimit te kontrates mbi cmimin total te kontrates se ndertimit. Duke qene se pagesat progresive, apo parapagimet nga bleresi mund te percaktohen (sipas marreveshjes midis paleve) ne momente te caktuara kohore, psh. 10% ne nenshkrimin e kontrates, 50% pas nje viti dhe 40% ne perfundim te punimeve, ne shumicen e rasteve, flukset monetare qe hyjne ne shoqeri bazuar ne faturimet per klientin sipas kontrates, nuk do te perputhen me punimet e kryera si dhe me te ardhurat qe lidhen me to bazuar ne aplikimin e metodes se fazes se perfundimit te kontrates se ndertimit.

Shenim: Ne pjesen e ilustrimeve, kandidatet mund te kene paraqitur shembuj te tjere qe do te vleresohen si te pershtatshem ose jo, bazuar ne gjykimin e korrigjuesit

21. Shoqëria mëmë “Axe” ka këtë informacion financiar më 31.12.2017 marrë nga pasqyrat e saj financiare individuale:

(6 pikë)

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktive afatgjata materiale, neto	190,000	140,000
Investim në njësi të kontrolluara	10,000	10,000
Hua ndaj njërive të kontrolluara	30,000	46,000
Paraja në bankë	34,000	20,000
Totali i aktivitet	264,000	216,000
Llogari të pagueshme	100,000	38,000
Kapitali	118,000	118,000
Fitimet e pashpërndara	46,000	60,000
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	264,000	216,000

Të përfshira në llogaritë e pagueshme të shoqërisë "Axe" më 31.12.2017 janë detyrime ndaj Shoqërisë «Cxe» në të cilën shoqëria "Axe" zotëron një investim në pjesëmarrje.

Gjatë vitit 2017, ajo kontrollon njësinë "Bxe", e cila ka këtë informacion financiar me 31.12.2017:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktive afatgjata materiale, neto	50,000	45,000
Llogari të arkëtueshme	25,000	35,000
Paraja në bankë	10,000	10,000
Totali i aktivitet	85,000	90,000
Hua nga palët e lidhura	30,000	66,000
Llogari të pagueshme	35,000	6,000
Kapitali dhe fitimet e pashpërndara	20,000	18,000
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	85,000	90,000

Përfshirë në llogaritë e arkëtueshme të "Bxe" është një faturë për "Axe" e lëshuar më 24 tetor 2015 në vlerën 15,000 Lek.

Kërkohet: Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të shoqërisë "Axe" më 31.12.2017 duke treguar llogaritjet tuaja.

Përgjigje:

	Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2017					
	Axe	Bxe	Eliminim 1	Eliminim 2	Eliminim 3	Totali
Aktive afatgjata materiale, neto	190,000	50,000	-	-	-	240,000
Investim në njësi të kontrolluara	10,000	-	(10,000)	-	-	-
Hua ndaj njësive të kontrolluara	30,000	-	-	-	(30,000)	-
Llogari të arkëtueshme	-	25,000	-	(15,000)	-	10,000
Paraja në bankë	34,000	10,000	-	-	-	44,000
Totali i aktivitet	264,000	85,000	(10,000)	(15,000)	(30,000)	294,000
Hua nga palët e lidhura	-	30,000	-	-	(30,000)	-
Llogari të pagueshme	100,000	35,000	-	(15,000)	-	120,000
Kapitali	118,000	20,000	(10,000)	-	-	128,000
Fitimet e pashpërndara	46,000	-	-	-	-	46,000
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	264,000	85,000	(10,000)	(15,000)	(30,000)	294,000

Eliminimi 1

Gjate konsolidimit investimi ne njesi te kontrolluara ne pasqyren e pozicionit financiar te shoqerise meme eliminohet kundrejt kapitali te njesise se kontrolluar.

Eliminimi 2

Llogaritë e arkëtueshme të “Bxe” në vlerën 15,000 Lek eliminohen kundrejt llogarive te pagueshme te “Axe” .

Eliminimi 3

Huate ndaj njesive te kontrolluara të “Bxe” në vlerën 30,000 Lek eliminohen kundrejt huave nga palet e lidhura te “Axe” .

Totali

Zerat e aktiveve dhe detyrimeve te shoqerise meme dhe njesise se kontrolluar mblidhen ze me ze per te pergatitur pasqyren e konsoliduar te pozicionit financiar te shoqerise meme.

Seksioni IV

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

- 22.** Shoqëria tregtare e huaj **GIG** i ka dhënë me qira shoqërisë tregtare shqiptare **ABX sh.p.k.** një makineri, të cilën kjo e fundit do ta përdorë për 5 vjet. **(4 pikë)**

Marrëveshja parashikon që **ABX sh.p.k.** do të paguajë për përdorimin e makinerisë 2 \$ për cdo orë punë të përdorimit të makinerisë, me kushtin që niveli më i ulët i përdorimit të makinerisë nuk mund të jetë më pak se 1500 orë.

Kërkohet: Me supozimin se makineria është përdorur në fakt 1300 orë pune në vitin 2017, të llogariten të ardhurat që do të njohë shoqëria e huaj **GIG** dhe njëkohësisht kostot e qirasë të shoqërisë **ABX sh.p.k.**

Përgjigje:

GIG do të njohë të ardhurat nga qeraja e makinerisë bazuar në informacionin që do të marrë nga ABX shpk, për orët e punës të kryera, por ne asnjë rast për më pak se 1500 ore gjatë cdo viti. Në vitin 2017 janë kryer 1,300 orë pune prej makinerisë. Në keto kushte të ardhurat e GIG duhet të ishin 2600 \$. Por duke qenë se kushti minimal është 1500 ore, atëherë të ardhurat llogariten në 3000 \$ dhe po kaq janë edhe shpenzimet e qirase edhe për shoqërinë shqiptare **ABX shpk**

- 23.** Më datën 14 Janar 2017, shoqëria ABC shpk i ka shitur shërbime një klienti të huaj në shumën 10,000 dollarë. Kursi i këmbimit në këtë datë ishte 100 lekë/dollar. Shuma në dollarë u arkëtua më datën 2 Mars 2017, kur kursi i këmbimit ishte 95 lekë/dollar.

(4 pikë)

Kërkohet:

- Të paraqiten shumat me të cilën do të njihen të ardhurat, në momentin kur ato plotësojnë kriteret e njohjes
- Të llogariten humbjet ose fitimet nga këmbimi më datën 02 Mars 2017. Të paraqiten skematikisht regjistrimet në ditar?
- Nëse në fund të periudhës 31.12.2017, shoqëria do të kishte gjendje në një llogari XXX në bankë shumën 3,000 USD dhe gjithashtu, edhe një faturë të një furnitori të paslyer në Shumën 5000 Euro, cilat do të ishin të dhënat që duhet të kemi për të llogaritur diferencat nga këmbimi.

Përgjigje:

Në momentin e shitjes

Debi Llogaritë e Arkëtueshme 1,000,000 (10,000 x 100)

Kredit Shitjet 1,000,000

Ne momentin e arketimit te te ardhurave, regjistrimet në ditar në lekë do të paraqiteshin:

Debit Banka/Paratë (likuiditetet) 95,000

Debit Humbje nga këmbimi 5,000

Kredi - Llogari të arkëtueshme 100,000

Humbjet nag kembimi jane $100,000 - 95,000 = 5000$

Per te bere llogaritjet do na duhej si informacion:

(a) Kursi i kembimit i dates se mbylljes

(b) Kursi i kembimit ne daten kur eshte regjistruar fatura e furnitorit

(c) Vlera kontabel ne leke e llogarise xxx

24. ABC sh.p.k. është shoqëri që merret me shitjen dhe riparimet e paisjeve elektronike. Kjo shoqëri në nëntor të vitit 2017 ka lidhur një marrëveshje me shoqërinë **ANDRI sh.p.k.** për të riparuar 20 paisje. Parashikohet që këto riparime do të kushtojnë 250 mijë lekë. Cmimi i rënë dakord për këto riparime është 300 mijë lekë. Kontrata parashikon që pagesa do të bëhet 40% në momentin e lidhjes së saj dhe 60% në momentin e përfundimit të shërbimit. Në fund të vitit 2017 konstatohet se është kryer 60% e punimeve të riparimit

(5 pikë)

Kërkohet: Duke supozuar skenarët më poshtë:

(a) **ANDRI sh.p.k.** ka konfirmuar se do të paguajë shërbimin dhe është në pritje të përfundimit të këtij riparimi.

(b) **ANDRI sh.p.k.** ka shumë mundësi që të mos paguajë plotësisht për shërbimin për faktin që ka vështirësi financiare dhe mund të pranojë pagimin e riparimit të vetëm 10 paisjeve.

(c) Sipas kontratës, në rast mospagimi të riparimit nga **ANDRI shpk**, **ABC sh.p.k.** ka të drejtë të shesë tek te tretët paisjet e riparuar dhe me të ardhurat e realizuara nga kjo shitje të mbulojë vlerën e riparimit dhe pjesën tjetër nëse mbetet, t'ja kthejë shoqërisë **Andri sh.p.k.** Shoqëria **ABC sh.p.k.** vlerëson se vlera e shitjeve në treg e paisjeve është 150,000 lekë dhe ajo ka gjetur një blerës potencial të tyre

Tregoni si do të veprojë ABC sh.p.k. për njohjen e të ardhurave nga shërbimi.

Përgjigje:

Ne te gjithë skenaret arkëtimi prej 40% te kontrates nuk do të njihet si e ardhur nga **ABC shpk** në momentin e arkëtimit sepse nuk eshte kryer shërbimi

a) Në fund të vitit ajo do të njohë si të ardhur 60% të 300 mijë lekë pra 180 mijë sepse ka kryer shërbimin dhe ka siguri që do t'i realizojë këto të ardhura në të ardhmen.

b) Meqenese nuk ka siguri ne arketimin e sherbimit, atehere sipas kerkesave te standardit per te ardhurat, ne keto lloj kontratash sherbimi, te ardhurat njihen deri ne masen e kostove te sherbimit te realizuara te pritshme per t'u rikuperuar. Prandaj per vitin 2017 do

te njihen ne te ardhura 60% e koston se riparimit te vetem 10 pajisjeve elektronike. Pra $(250.000 / 2) * 60\% = 75.000$ leke

(c) Meqenëse në 2017 koston e kryera për shërbimin pritët të rikuperoheh përmes shitjes tek blerësi potencial (kosto $250.000 * 60\% = 150.000$ lekë / shitja 150.000 lekë), atëherë do të njihen në kontabilitet si të ardhura nga shërbimi 60% e vlerës së kontratës së shërbimit, që do të thotë $300.000 * 60\% = 180.000$ lekë.

Seksioni V

Kontabiliteti i Koston dhe i Drejtimit

25. Për secilën nga firmat e mëposhtme, përcaktoni duke shënuar në kutinë përkatëse, nëse ka më shumë të ngjarë të përdorë sistemin e koston për porosi apo për prodhimin e vazhdueshëm, kur kjo firmë: **(4 pikë)**

Aktiviteti	Sistemin e koston së prodhimit për porosi	Sistemin e koston për prodhimin e vazhdueshëm
Ofron shërbime ligjore	x	
Është një klinikë për kujdesin e shëndetit	x	
Prodhon tekste për kolegjet	x	
Është një servis makinash	x	
Prodhon perime të konservuara		x
Dizenjon programe kompjuterike sipas kërkesave të klientëve	x	
Është një shoqëri që prodhon filma	x	
Prodhon dyshekë me ajër për t'u përdorur në pishina		x

Cdo përgjigje e sakte e cekuar në kuti vlerësohet me 0.5 pike

26. Entrada, një firmë e zbulurimeve të brendshme, përdor sistemin e koston për porosi dhe i rëndon shpenzimet e përgjithshme të porositë duke përdorur një koeficient të paracaktuar prej 170 Lekë për orë të punës direkte. Në 1 korrik 2015, porosia #918 ishte e vetmja në proces. Kostoja e saj përfshinte materiale direkte prej 82.500 Lekë dhe punë direkte prej 5.000 Lekë (250 orë me 20 Lekë për orë). Gjatë korrikut filloi punën me porositë #919, #920, dhe #921. Materialet direkte të përdorura për korrikun ishin gjithsej 216 500 Lekë. Kostoja e punës direkte për korrikun ishte gjithsej 63.000 Lekë. Porosia #920 nuk ishte përfunduar ende në fund të korrikut, dhe shumat e saj për materialet direkte dhe punën direkte ishin respektivisht 28.500 Lekë dhe 8.000 Lekë. Të gjitha porositë e tjera u përfunduan në korrik.

(5 pikë)

Kërkohet:

- a) Sa ishte kostoja totale e porosisë #920 në fund të korrikut 2015?
- b) Sa ishte kostoja e produkteve të prodhuara për muajin korrik 2015?

Përgjigje:

a) kostoja e porosisë 920

(2 pike)

Kostoja totale e prodhimit = MD+PD+SHPP

Per porosine nr 920 kemi MD= 28500, PD = 8 000 dhe per te gjetur SHPP qe do ti shperndahet kesaj porosie, llogarisim fillimisht oret e punes direkte (8000/20 Leke ore) =400 ore pune Keshtu SHPP do te jete 400 ore pune direkte *170 Leke=68 000 leke

Kostoja totale e prodhimit 104500 leke

b) Kostoja totale e produkteve te prodhuara

(3 pike)

Gjendja ne fillim e prodhimit ne proces + kostoja e prodhimit gjate muajit – gjendja e prodhimit ne proces ne fund = Kostoja totale e produkteve te prodhuara.

Gjendja ne fillim eshte sa kostoja e porosisë 918 = (82500+5000+250*170)=130 000 leke (1Pike)

Kostoja e prodhimit gjate muajit Korrik eshte 216500 +63000+ (63000/20)*170=815000leke
(1 pike)

Gjendja ne fund e prodhimit ne proces eshte sa kostoja e porosisë 920 e llogaritur ne piken a. 104 500leke

Kostoja e produkteve te prodhuara do te jete duke bazuar ne formule 840 500 leke (1pike)

Seksioni VI

Analiza e Pasqyrave Financiare

27. Shoqëritë AlbMarket dhe GrandMarket, të dyja operojnë në sektorin e tregtisë me pakicë. Për vitin 2017, shoqëria AlbMarket ka një marzh fitimi prej 4 përqind të shitjeve. Kurse shoqëria GrandMarket, për të njëjtën periudhë, ka qarkullim të aktiveve totale të saj të barabartë me 6 herë. Kthimi mbi aktivet i të dy shoqërive është 12 përqind, por nga analistët financiarë konsiderohet i pamjaftueshëm pasi është nën mesataren e sektorit së tregtisë me pakicë.

(4 pikë)

Kërkohet:

1. Llogarisni treguesin e qarkullimit të aktiveve totale për shoqërinë AlbMarket dhe marzhin e fitimit të shoqërisë GrandMarket.
2. Cfarë strategjie do të rekomandonit për përmirësimin e performancës, (pra rritjen e kthimit mbi aktivet totale) për shoqërinë AlbMarket? Po për shoqërinë GrandMarket?

Përgjigje:

1. Duke ditur se treguesi i kthimit mbi aktivet është i barabartë me qarkullimin e aktiveve totale herë marzhin e fitimit mund të llogarisim çfarë kërkohet në pikën 1.

Pra (ROA) Kthimi mbi aktivet = Qarkullimi i aktiveve totale * Marzhi i fitimit.

Qarkullimi i aktiveve totale për shoqërinë Albmarket do të jetë 3 herë (12 përqind / 4 përqind që është marzhi i fitimit).

Marzhi i fitimit i shoqërisë GrandMarket do të jetë 2 përqind (12 përqind / 6 herë).

2. Nisur nga llogaritjet e bëra në kërkesën 1 më lart, mund të bëjmë një përmbledhje krahasuese si më poshtë:

	Albmarket	Grandmarket
Marzhi i fitimit	4 përqind	2 përqind
x Qarkullimi i aktiveve totale	3 herë	6 herë
= Kthimi mbi aktivet	12 përqind	12 përqind

Bazuar në çfarë shohim mund të themi se çfarë ka nevojë të përmirësojë shoqëria Albmarket është qarkullimi i aktiveve totale (i cili është 2 herë më i ulët se marzhi i shoqërisë konkurrente). Por duke ditur se qarkullimi i aktiveve totale ka lidhje të zhdrejtë me marzhin e fitimit shoqëria duhet të jetë e kujdesshme që ndërkohë që rrit qarkullimin e aktiveve, të mos ulë marzhin e fitimit.

Cfarë konkretisht mund të bëjë shoqëria Albmarket, është që: (1) të përmirësojë përdorimin e aktiveve të saj së pari duke nxjerrë jashtë shfrytëzimit aktivet operative jo funksionale (pra që aktualisht nuk shfrytëzohen më në procesin e prodhimit), (2) duke përmirësuar

investimin në zërat e klientëve dhe inventarit, dhe (3) së fundmi mund të zbatojë strategjitë e qiramarrjes (operative) për të mosçenuar eficiencën operative e njëkohësisht duke përmirësuar qarkullimin e aktiveve afatgjata.

Shënim: kandidatët mund të zgjedhin një nga tre alternativat më lart

Kurse shoqëria Grandmarket ka nevojë të përmirësojë marzhin e fitimit që është sa gjysma e marzhit të fitimit të shoqërisë konkurrense. Kjo mund të arrihet duke (1) rishikuar cmimet e shitjeve të produkteve; (2) duke ushtruar kontroll mbi kontratat e blerjeve nga furnitorët si edhe mbi kostot e tjera të blerjes së mallrave dhe (3) duke rishikuar shpenzimet operative të dyqaneve të saj të shitjes me pakicë.

Shënim: kandidatët mund të zgjedhin një nga tre alternativat më lart

28. Nga pasqyrat financiare të shoqërisë Drina, për vitin që mbyllet në 31/12/2017 kemi shkëputur informacionet e mëposhtme: (të dhënat në mijë lekë)

(5 pikë)

Mjete monetare dhe ekuivalentë 8.500
Inventari tregtar 18.000,
Kërkesa për arkëtim 20.000,
Paradhënie për funitorët 14.000,
Investime në letra me vlerë afatshkurtër 5.000
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit 175.000,
Detyrimet afatgjata 43.000,
Detyrimet afatshkurtra 30.000.

Kërkohet:

1. Llogarisni dhe komentoni për vitin 2018 këta tregues të analizës së likuiditetit:
 - a) Raportin Korrent,
 - b) Raportin e Shpejtë
 - c) Raportin Likuid të shoqërisë.

Nëse shoqëria synon të rrisë raportin korrent (pasi banka ku ajo ka marrë kredi kërkon që ky raport të jetë të paktën 250%) atëherë cfarë veprimesh mund të ndërmarrë ajo që të arrijë këtë synim? Specifikoni të paktën dy veprime të tilla.

Përgjigje:

a) Raporti korrent = AASH / DASH

Ku aktivet afatshkurtra janë shuma e zërave të mjeteve monetare, inventarit, kërkesat për arkëtim, paradhënie për furnitorët dhe investime në letra me vlerë afatshkurtra, pra në total AASH janë 65.500 lekë

Pra raporti korrent = 65.500 lekë / 30.000 lekë = 2,18 herë ose 218 përqind

Komenti: Vlera e këtij raporti është tepër afër me vlerën optimale të tij prej 2 herë afërsisht, pra shoqëria ka vlera të mjaftueshme në aktivet e saj afatshkurtra për të mbuluar lirisht detyrimet afatshkurtra të saj.

b) Raporti i shpejtë = (AASH – Inventari) / DASH

shënim: Sipas SKK2 parapagimet për inventar, pra paradhëniet për furnitorët përfshihen në inventar dhe rrjedhimisht do të zbriten nga numëruesi i formulës së llogaritjes së raportit të shpejtë.

Pra: Raporti i shpejtë = $(65.500 - 18.000 - 14.000) / 30.000 = 33.500 / 30.000 = 1,12$ herë

Komenti: Duke ditur se vlera optimale e raportit të shpejtë është rreth 1,5 herë mund të themi se shoqëria mund të gjendet në vështirësi pagese të detyrimeve afatshkurtra, nëse nuk shitet në kohë inventari që ajo ka.

c) Raporti likuid = Aktive likuide / DASH = $8.500 / 30.000 = 0,28$ herë ose 28 përqind

shënim: në aktivet likuide përfshihen vetëm mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre pasi nuk ka informacion që letrat me vlerë afatshkurtra janë mjaftueshëm likuide sa të konsiderohen aktive likuide.

Komenti: Meqënëse vlera e raportit likuid preferohet të jetë minimalisht 50 përqind mund të themi se shoqëria (me një vlerë prej vetëm 28 përqind) nuk mban teprica të nevojshme likuiditetesh për të mbuluar kërkesat e saj nga ana e detyrimeve afatshkurtra.

2. Shoqëria ka aktualisht vlerën e raportit korrent 2,18 herë dhe duhet ta rrisë këtë vlerë në 2,5 herë. Mënyrat për të arritur këtë janë ose:

A) **duke shtuar vlerat në zërat e aktiveve afatshkurtra;** p.sh, duke mbajtur më shumë vlera monetare (dhe rrjedhimisht përmirëson edhe vlerën e raportit likuid); duke shitur më shumë inventare me arkëtim të mëvonshëm, cka rrit kërkesat për arkëtim dhe përmirëson treguesin e raportit të shpejtë, i cili edhe ky kishte nevojë të përmirësohej, ose

B) **duke pakësuar vlerat në zërat e detyrimeve afatshkurtra;** p.sh, duke pakësuar detyrimet e llogarive të pagueshme apo pagave të pagueshme (cfarëdo të jenë zërat që ka shoqëria në detyrimet afatshkurtra të saj).

Klodian Mene

Kryetar

Komisioni i Provimeve të Aftësisë Profesionale